


KISHA E SHEN KOLLIT



JU FTON TË VINI PËRSËRI!

TË DJELËN, NË 28 QERSHOR, NA ËSHTË DHËNË LEJA TË FILLOJMË TË RIHAPIM KISHËN. JU FTOJMË TË VINI NË SHTËPINË TUAJ PORSA TË NDJEHENI MIRË PËR TË ARDHUR PËRSËRI. JU LUTEMI SHIKONI RREGULLAT E MË POSHTME. KËTO RREGULLA JANË PËR TË NDIHMUAR TË GJITHË NE. SHIKOHEMI SE SHPEJTI!

Me qëllim që të ndiqni shërbimin:

1. Mer në telefon në numrin e Kishes 718-380-5684. Lër mesazh për ditën që preferoni. gjithashtu lini numrin e telefonit ku të telefonojmë.
2. Do tu marim në telefon për të konfirmuar rezervimin. Numri i njerëzve që do ndjekin shërbimin është i kufizuar. Ju lutemi mos e merni për ofendim në qoftë se nuk ju aprovojmë për cdo kerkesë.
3. Po sa të jeni njoftuar për ditën që do të ndiqni shërbimin, ju lutemi kontrolloni shëndetin. Ato që kanë shënja si të gripit duhet të rinë në shtëpi. Për më tepër, ato që janë në kategori më të larta reziku, ato që kanë sistem imun të dobët dhe në moshë mbi 65 vjec---keshillohen të presin para se të dalin në vende publike.
4. Në qoftë se për ndonjë arsye ju mund të ndroni planin për të ardhur në Kishë, ju lutemi na njoftoni në të njëjtin numër si më sipër kështu që ne mund të njoftojmë dikë tjetër.
5. Kur vini në Kishë duhet të keni maskën e cila është e detyruar të vishet gjatë gjithë kohës së shërbimit dhe nga të gjithë mbi moshë 2 vjet. Ne nuk dëshirojmë të kthejmë njeri ndersa Kisha ka një sasi të kufizuar maskash dhe ju mund të haroni maskën.
6. Planifiko të kesh ndonjë xhakëtë të lehtë ose shall pasi dritaret e Kishës dhe kondicioneri do jenë të hapura gjatë shërbimit për të siguruar qarkullim të vazhdushëm të ajrit të freskët.
7. Hajdeni herët në Kishë. Shërbimi fillon në orën 10 dhe dyert do mbyllën në 10:05.
8. Hyr dhe dil nga Kisha nga dera anësore. Dyert kryesore do jenë të mbyllura.
9. Kur të hyni në Kishë firmosni në librin e duhur, shkruani numrin e telefonit dhe matni temperaturën.
10. Salla poshtë është e mbyllur. Përdorni banjot që janë në fund të shkallëve kryesore dhe jo atë që është brënda në sallë e njohur si banjo e burrave. Ju lutemi lani duart shpesh. Qendra sanitare ka sapo te hyni ne Kishë dhe pranë tavolinës së qirinjeve.
11. Ju mund ti respektoni ikonat duke u përkulur përballë tyre dhe duke bërë kryqin. Ju lutemi mos prekni ose puthni ikonat, kupën e verës, kryqin, ose dorën e priftit derisa reziku i virusit të kalojë.
12. Do tu caktohet vendi se ku do rini gjatë shërbimit. Kjo nuk është zgjedhja juaj dhe nuk duhet të levizni në një vend tjetër. Jemi të detyruar të mbajmë distancën midis atyre që ndjekin shërbimin.
13. Në kohën e Kungimit, Fr. Niko do tju ftoj sipas radhës. Qëndroni në vëndin tuaj deri sa tu thonë kur të afroheni për Kungim.
14. Si masë e përkohëshme gjatë kësaj kohe, Kungata do meret duke përdorur më shumë se një lugë te cilat do sterilizohen gjate perdorimit.
15. Koha a Kafes, Shkolla e Kishës dhe Klasat shqip nuk do të hapen gjatë kësaj kohe. Në fund të Liturgjisë, në qoftë se dëshironi të takoheni dhe shoqëroheni me të tjerët, ju lutemi bëheni jashtë Kishës. Kjo na ndihmon ne të mbajmë Kishën sa më pastër të jetë e mundur duke e ditur ku dhe çfarë duhet sterilizuar.